BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6- 18 MUAJSH PËR MUAJIN MAJ

PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Kuriozitete për muajin MAJ

Çfarë duhet të dimë përmuajin MAJ?

* Muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve
* Muaji Maj është quajtur muaji i biçikletave.
* Në muajin Maj piqen luleshtrydhet.
* Në muajin Maj çelin lulet.

Muaji Maj -Tema: Format e argëtimit dhe lojrat

Grupi: 6-18 muajsh

* **Java I**: Format e argëtimit
* **Java II**: Lojërat me ngjyrat
* **Java III**: Lojërat me numrat
* **Java IV**: Lojra me fëmijët.

Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojrat		
Temat Javore	**Qëllimi**	**Koha e realizimit**
Format e argëtimit	Të njohim fëmijët me format e argëtimit. Disa elementë të rëndësishëm që ndikojnë pozitivisht në aspektin social dhe argëtues të jetës së tyre.	Java I
Lojërat me ngjyra	Përsëritja e ngjyrave kryesore përmes punës së dorës dhe lojrave	Java II
Lojrat me numrat	Përsëritja e numrave 1-3 dhe organizimi i lojrave dhe aktiviteteve me këta numra.	Java III
Programi për 1 Qershorin dhe aktivitete krijuese.	Lojra me fëmijët	Java IV

Shënim:

Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

Sugjerim: Edukatoret në rastet kur në program ka punë krijuese mund të përgatisin programin në mëngjes herët, ose në orarin e pasdites kur fëmijët largohen.

Kujdes: Edukatoret duhet të jenë gjithmonë pjesë e lojës bashkë me fëmijët.

Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojrat

Tema e javës: Format e argëtimit.

Java I	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Sporti dhe rëndësia e tij. 	**Ndërveprim edukatore-fëmijë**: Edukatorja orienton fëmijët të kryejnë lëvizje gjimnastike elementare. Edukatorja përpiqet të bëjë ushtrime elementare për fëmijët (duart lart, anash, poshtë, kërcim në vend). **Loja me top:** Edukatorja vendos fëmijët në rreth dhe i shpjegon atyre lojën me pasime me top. Fëmijëve iu duhet demostruar si ta pasojnë topin me njëri- tjetrin. Edukatoret ulen të luajnë bashkë me fëmijët. **Vjersha**: "Topi im ".	Mjetet Didaktike: Topa me ngjyra. Manuali i Vjershave

E Martë	Libri, një mik i mirë i fëmijëve. 	**Ndërveprim edukatore-fëmijë**: Edukatorja i tregon fëmijëve librat që ndodhen në grupin e tyre. Bashkë me fëmijët ajo shfleton librat duke iu treguar figurat, objektet dhe nëse mundet ja konkretizon duke ja treguar nëpërmjet objekteve të prekshme në çerdhe. **Loja:** Vendosja e tre koshave me ngjyra të ndryshme (Koshi: i kuq, blu dhe i verdhë) si dhe hedhja e topave me ngjyrat përkatëse në koshat përkatës. Edukatorja bashkë me fëmijët, hedh në kosh topin me ngjyrë të njëjtë me koshin dhe artikulon ngjyrën.	Mjetet Didaktike: Librat që disponohen nën grup. Kosha me ngjyra, topa me ngjyra.
E Mërkurë	Muzika dhe fëmijët 	**Aktivitet**: Edukatorja i vendos fëmijëve muzikë dhe kërcen bashkë me fëmijët. Ajo iu tregon fëmijëve veglat muzikore që disponon në grup, luan ato bashkë me fëmijët duke i sjell shpesh në vëmendje nivelet e zhurmës së tingujve (e lartë, i ulët) **Muzikë**: Fëmijët dëgjojnë muzikë dhe kërcejnë. **Lojë e lirë:** me kuba, kukulla, lodra.	Mjetet Didaktike: Veglat muzikore të disponueshme në grup.
E Enjte	Fëmijët dhe kërcimi	**Ndërveprim edukatore-fëmijë**: Edukatorja kërcen dhe shfaq gëzim duke e identifikuar gëzimin dhe emocione të tjera (p.sh. kur kërcejmë ndihemi të gëzuar, energjikë etj.) **Kërcimi:** Kërcimi tango-tango.	Mjete didaktike: Mësojmë në youtube levizjet e këngës për tjua mësuar fëmijëve.

E Premte	Mësojmë të vizatojmë një buzëqeshje.	**Demostrim:** Edukatorja i demostron fëmijëve fytyrën e qeshur dhe i kërkon atyre ta imitojnë atë. **Krijim:** Edukatoret krijojnë dy emocione me emoji (i qeshur dhe i trishtuar) si në figurë dhe i kërkojnë fëmijëve të imitojnë fytyrën e qeshur dhe të trishtuar. (12 – 18 muajsh) **Këngë lëvizore:** "Kur jam i gëzuar përplas duart"	Fleta të verdha, shkopinj.

Tema e javës: Njohja me ngjyrat			
Java II	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Ngjyra e kuqe 	**Ndërveprim edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu demostron fëmijëve nëpërmjet objekteve të ndryshme ngjyrën e kuqe. Edukatorja bashkë me fëmijët prek në dhomë objekte që kanë ngjyrë të kuqe. Edukatorja identifikon ku ndodhet ngjyra e kuqe tek veshjet e fëmijëve. **Vjersha:** "Qershia"	Mjetet Didaktike: Manuali i Vjershave. Lapsa me ngjyra.
E Martë	Ngjyra e gjelbër 	**Ndërveprim edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu demostron fëmijëve objekte me ngjyrë të gjelbër. Ajo i tregon se ku e gjejmë ngjyrën e gjelbër. **Vizatim:** Edukatorja i tregon fëmijëve bretoskën dhe kafshë të tjera në ngjyrë të gjelbër. Fëmijët ulen të ngjyrosin me bojëra dhjami bretkosën. **Vjersha:** "Tullumbace të kam xhan".	Mjetet Didaktike: Manuali i vjershave. Figura të bretkosave, breshkave etj.
E Mërkurë	Ngjyra Blu 	**Ndërveprim edukatore-fëmijë**: Edukatorja i demostron fëmijëve objektet me ngjyrë blu. Ajo vendos me ngjitje në tokë fleta A4 me ngjyrat (blu, kuqe, jeshile), ngjyrat e mësuara deri më tani dhe bashkë me fëmijët klasifikon objektet sipas ngjyrave mbi kartona. Pra bën përputhjen e objekteve me ngjyrat (*ilustruar në foton djathtas).* **Vjersha:** " Tullumbace të kam xhan" **Loja:** "Prekim tollumbacet blu" **Shpjegim:***Tollumbacet blu i mbushim me lëndë të ndryshme (ujë, oriz, fasule, xhelatinë,kripë) dhe i vendosim që fëmijët ti prekin. Gjatë kohës që ata i prekin i tregojmë se si janë tollumbacet, p.sh. e butë, bosh, e fortë)*	Mjetet Didaktike: Tollumbace blu (oriz, miell. Fasule, ujë etj).Letra, toptha të vegjel me ngjyra.

E Enjte	Ngjyra e verdhë 	**Ndërveprim edukatore - fëmijë**: Edukatorja sjell në ambjentin e çerdhes objekte/figura me ngjyrë të verdhë (limon, diell, letra, kafshë kryesisht zogj me ngjyrë të verdhë) dhe i demostron fëmijëve ngjyrën dhe ku e gjejmë atë. **Këngë lëvizore:** 1, 2	Mjetet Didaktike: Objekte me ngjyrë të verdhë.
E Premte	Përsëritja e ngjyrave bazë të mësuara (Blu, e kuqe, e gjelbër, e verdhë).	**Krijim:** Në një karton të madh, formojmë disa rrathë me ngjyrat që kemi mësuar deri më tani dhe bashkë me fëmijët fusim brenda topat përkatës me ngjyrë të njëjtë. P.sh. topi i kuq brenda rrethit të kuq. Veprimi kryhet bashkë me edukatoren. Shembull: E demostruar në fig.mjetet didaktike. **Vjersha:** "Qershia" **Përralla**: "Kutia e bojrave"	Manuali i Vjershave

Tema e javës: Lojrat me numrat			
Java III	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Njohja me numrat 1-3	**Vjersha:** "1, 2, 3" **Këngë lëvizore:** Shoqëruar me instruksione (p.sh 1, 2, 3 fillojmë. 1, 2, 3 hidhu. 1, 2,3 përplas duart)	.
E Martë	Krijimi i krimbit me numrat 1, 2, 3 	**Krijim**: Edukatoret ndërtojnë krimbin dhe ngjisin numrat sipas renditjes 1, 2, 3 tek rrathët. Edukatoret lexojnë numrat fëmijëve duke i identifikuar me gisht. **Vjersha:** 1, 2, 3	Mjetet Didaktike: Fleta me 3 ngjyra për të ndërtuar radhët e krimbit. Numra të prera i ngjisim te rrathët.
E Mërkurë	Eksplorimi i numrave dhe formave 2D	**Krijim:** Krijojmë tre numra dhe forma të ndryshme me mjete të ndryshme (pipza) dhe i kërkojmë fëmijëve ti prekin. Fëmijët i prekin pasi marrin komandën nga edukatorja për të prekur numrin dhe formën përkatëse. **Përralla:** "Tri fluturat" **Vjersha:** " Lepuri" **Këngë lëvizore:** 1,2	Mjetet Didaktike: Manuali i vjershave dhe këngëve. Pipza.

E Enjte	Numërojmë përmes shqisave	**Bisedë edukatore-fëmijë.** Edukatorja i demostron fëmijëve pjesët e fytyrës me kujdes dhe i kërkon që edhe ata t'i tregojnë kur edukatorja pyet*(ku është hunda)*? Pasi edukatorja ka prekur bashkë me fëmijën pjesët e fytyrës, fillojnë dhe t'i numërojnë, *p.sh: dy sy, një hundë, dy veshë, një mjekër.* **Vjersha**:"1,2,3".	Mjetet Didaktike: Manuali i vjershave dhe këngëve
E Premte	Mësojmë të radhisim	**Vjersha**: "Lepuri" dhe "1, 2, 3" **Përsëritja e numrave** 1, 2, 3 **Përralla**: Tre Derrkucët	Manuali i Vjershave

Tema e javës: Lojra me fëmijët

Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Tuneli sensor 	**Vjersha: "**1Qershori ". **Krijim:** Krijimi i tunelit sensor. *(Me anë të një kartoni të madh si në figurë, edukatorja krijon tunelin ku do të kalojnë fëmijët. Në tunel lart, varim objekte të ndryshme funksioni i të cilave është të prekin fëmijën kur ai të kalojë).*	Kuti kartoni, geta, letra të prera për së gjati.

E Martë	Loja me brumë 	**Krijim:** Loja me brumë. Edukatoret përgatisin brumë dhe pasi kanë ulur fëmijët në tavolinë, punojnë bashkë më ta brumin në forma të ndryshme.(Kujdes: Edukatoret ulen të punojnë bashkë me fëmijët) **Vjersha:** "1 Qershori"	Mjetet Didaktike: Brumë. Manuali i vjershave.
E Mërkurë	Ushqejmë lepurushin. 	**Krijim:** Me anë të një kartoni ndërtojmë një lepurush si në figurë. Me letra të vogla krijojmë karrota dhe i vendosim në një kosh. Më pas i kërkojmë fëmijëve të ushqejnë lepurushin. Karrotat është e rëndësishme të jenë me ngjyra të ndryshme dhe duhet të instruktojmë fëmijët të fusin në gojën e lepurushit ngjyrat që edukatorja thotë (p.sh. i japim lepurushit karrotën e kuqe). **Vjersha:** "1 Qershori"	Kuti kartoni, letra të vogla me ngjyra. Manuali i vjershave dhe këngëve.
E Enjte	Cfarë është fshehur brenda? 	**Krijim:** Në një tabelë kartoni ngjisim pjesën hapëse të pecetave të lagura si në figurë. Brenda tyre vendosim foto të fëmijëve të cilat ja kemi kërkuar më parë prindërve. Më pas vendosim bashkë me fëmijët t'i zbulojmë duke i hapur dhe duke stimuluar që fëmijët të gjejnë fillimisht veten e tyre dhe më pas shokët. **Kërcim:** Edukatoret kërcejnë bashkë me fëmijët në rreth.	Mjetet Didaktike: Letra të lagura(ruajmë pjesën hapëse), foto të fëmijëve, ngjitës.

E Premte	Festa e 1 Qershorit 	**Festojmë:** Edukatoret festojnë me fëmijët festën e 1 qershorit. Me anë të mjeteve të ricikluesshme, përgatisin kartolina për fëmijët të cilat ja japin fëmijëve kur i përcjellin. **Vjersha:** 1 Qershori **Kërcim:** Fëmijët kërcejnë bashkë me edukatoret këngë për 1 qershorin.	Mjetet Didaktike: Punë dore e lirë.

Shënime:

Edukatorja shënon në fund të muajit vështirësitë dhe sugjerime lidhur me realizimin e programit!

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJSH
MUAJI MAJ

PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Kuriozitete për muajin MAJ

Çfarë duhet të dimë për muajin Maj?

* Muaji Maj është quajtur muaji i buzëqeshjeve.
* Muaji Maj është quajtur muaji i biçikletave.
* Muaji Maj është quajtur muaji i fotografisë.
* Muaji Maj është quajtur muaji i luleshtrydhes.
* Në muajin Maj çelin luleboret, trëndafili dhe tulipani.



Muaji Maj- Tema: Format e argëtimit dhe lojërat

Grupi: 18-24 muajsh

* **Java I**: Format e argëtimit
* **Java II**: Lojërat me ngjyrat
* **Java III**: Lojërat me numrat
* **Java IV**: Programi për 1 Qershorin



Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat

Temat Javore	**Qëllimi**	**Koha e realizimit**
Format e argëtimit	Të njohim fëmijët me format e argëtimit. Disa elementë të rëndësishëm që ndikojnë pozitivisht në aspektin social dhe argëtues të jetës së tyre.	Java I
Lojërat me ngjyrat	Përsëritja engjyrave kryesore përmes punës së dorës dhe lojërave.	Java II
Lojërat me numrat	Përsëritja e numrave 1-5 dhe organizimi i aktiviteteve dhe lojërave me këta numra.	Java III
Programi për 1 Qershorin		Java IV

Shënim:

* Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
* Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat			
Tema e javës: Format e argëtimit			
Java I	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Sporti dhe rëndësia e tij. 	**Bisedë edukatore-fëmijë**:Edukatorja iu flet fëmijëve për sportet dhe rëndësinë e tyre për shëndetin p.sh.: sportet forcojnë trupin dhe muskujt. Sportet na ndihmojnë të mësojmë të luajmë në grup. Disa lojëra zhvillohen në skuadër: futbolli, basketbolli, volejbolli, etj, në disa lojëra njerëzit garojnë vetëm: noti, vrapi, etj. **Loja e futbollit:** Edukatorja mëson dhe ndihmon fëmijët të godasin topin me këmbë. Loja zhvillohet në oborr. **Lojra me top:** Edukatorja zhvillon lojra të ndryshme me top (vendosja e fëmijëve në një rreth duke i ndihmuar t'i pasojnë topin njëri tjetrit, etj). Loja zhvillohet në oborr. **Vjersha**: "Topi im". **Vjersha:** "Beni". **Ngjyrosje:** Fëmijët ngjyrosin një top, të përgatitur më parë nga edukatorja.	Mjete Didaktike: fletë A4 të baardha, lapsa me ngjyra Libri "365 rrëfenja para gjumit".
E Martë	Libri një mik i mirë i fëmijëve.	**Bisedë edukatore-fëmijë:** Edukatorja iu tregon fëmijëve për librat, pse lexojmë (na ndihmon të mësojmë fjalë të reja, na rrit fantazinë, etj). Edukatorja iu tregon fëmijëve librat në grupin e tyre i shfleton me ta, ju tregon figurat, etj. **Loja:** "Libri i përkimit të ngjyrave". **Vjersha**: "Librat rradhë-rradhë". **Përralla:** "Zonja Lepurushe". **Lojë e lirë**: me kuba, me lodra, me kukulla.	Mjete Didaktike Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave "Ejani të luajmë" Libri me përralla "365 rrëfenja para gjumit" f.73
E Mërkurë	Muzika dhe fëmijët.	**Bisedë edukatore-fëmijë:** Edukatorja u tregon fëmijëve për muzikën (çfarë këngësh ju pëlqejnë atyre, a ju këndon mami në shtëpi, a i pëlqen të dëgjojnë këngë, etj. Ato i tregojnë fëmijëve veglat muzikore (lodra ose figura). **Vjersha** "Këngë lëvizore". **Përralla:** "Talent për skenë".	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libri "365 rrëfenja para gjumit".

		Aktivitet i lirë: muzikë dhe kërcim.	
E Enjte	Fëmijët dhe kërcimi	**Bisedë edukatore-fëmijë në lidhje me kërcimin:** Kërcimi është një aktivitet argëtues për fëmijët dhe për rriturit. Kur kërcejmë trupi jonë vihet në lëvizje sipas ritmit të muzikës. Kërcimi na bën të ndihemi më të gëzuar, etj. **Përralla:** "Mësim Dansi". **Këngë**: "Kënga lëvizore". **Lojë e lirë:** Edukatoret improvizojnë bashkë me fëmijët kërcime të ndryshme (mund të imitohen lëvizjet/ecjet/kërcimet/zvarritjet e kafshëve të ndryshme. Ose të improvizohen lëvizjet e valleve/kërcimeve të njohura si: Kënga e Pinguinit apo këngët lëvizore që i bëjnë shumë animatorë, por janë të njohura edhe nga edukatoret.)	Manuali i Vjershave Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.142)
E Premte	Mësojmë të vizatojmë një buzëqeshje. 	**Vjersha**: "Topi im". **Lojë energjike**: me shami, me top, me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Bisedë: edukatore-fëmijë:** Edukatorja iu shpjegon fëmijëve që muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve. Ajo fton fëmijët të imitojnë me mimikë një buzëqeshje. **Aktivitet:** Fëmijët mësojmë të vizatojnë fytyrën e buzëqeshur. Pas vizatimit ata e ngjyrosin fytyrën me një ngjyrë sipas dëshirës. **Aktivitet i lirë:** Loja imituese	Mjete didaktike: letra dhe lapsa me ngjyra. Manuali i Lojrave "Ejani të luajmë"

Tema mujore: Format e argëtimit Tema e javës: Njohja me ngjyrat			
Java II	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Ngjyra e kuqe 	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Lojë energjike**: me shami, me top, etj. **Vjersha**: "Qershia". **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e kuqe dhe se ku e gjejmë atë: në natyrë, tek bimët, lulet, pemët, kodrat/tek kafshët, si p.sh: nusepashka, gaforrja/tek frutat dhe perimet: mollët, qershitë, luleshtrydhet, domatet, etj. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të kuqe që ndodhen në çerdhe. **Punë dore:** Krijimi i gaforres së detit. Edukatoret mund të përdorin ilustrimin e këtij materiali.	Mjete Didaktike: karton A3/mbështjellëse keku, letra me ngjyrë të kuqe/rozë, lapsa me ngjyra.
E Martë	Ngjyra e gjelbër 	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e gjelbër dhe ku e gjejmë atë: në natyrë, tek pemët, bari, gjethet/tek kafshët: bretkosa, etj/tek frutat dhe perimet: speci, kastraveci, brokoli. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të gjelbër që ndodhen në çerdhe. **Bisedë**: Bretkosa. Edukatorja iu flet fëmijëve për bretkosën, ku qëndron ajo (në lum, liqen), tingullin që lëshon, etj. Fëmijët imitojnë tingullin e bretkosës. **Përralla:** "Bretkosa e gjelbër". **Ngjyrosje ose punë dore**: fëmijët ngjyrosin me ndihmën e edukatores bretkosën.	Mjete Didaktike: plastelinë Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.74)
E Mërkurë	Ngjyra blu 	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën blu dhe se ku e gjejmë atë: ngjyra e detit, qiellit. I ndihmojnë fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë blu në	Manuali i Vjershave Mjete didaktike: plastelinë, kopsa.

		çerdhe. **Aktivitet me tullumbace**: Fëmijët me ndihmën e edukatores fryjnë tullumbace blu, të kaltra dhe lozin me to. Aktiviteti zhvillohet në oborr. **Vjersha:** "Tullumbace të kam xhan".	
E Enjte	Ngjyra e verdhë Krijojmë me punë dore luledielli/bletën	**Vjersha:** "Karrota". **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e verdhë dhe se ku e gjejmë atë: në natyrë, tek lulet si: luledielli)/tek shpendët, insektet, si bleta, zogu i verdhë etj/tek frutat dhe perimet, si p.sh, pjepri, speci, kungulli, banania, limoni. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të verdhë që ndodhen në çerdhe. **Lojë energjike**: kënga lëvizore 1 ose 2 e bërë me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr. **Ngjyrosje:** Fëmijët ngjyrosin lulen ose bletën. Edukatoret mund të përdorin ilustrimet në këtë material për ngjyrosje. **Lojë e lirë**: me kuba, lego, lodra.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë të bardha A4. 
E Premte	Përsëritje e ngjyrave bazë të mësuara (blu, e kuqe, e gjelbër, e verdhë) Krijojmë ylberin me plastelinë	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrat që mësuan gjatë javës (blu, e kuqe, e verdhë, e gjelbër) dhe përsërit së bashku me fëmijët se ku i gjejmë ato: në natyrë, tek bimët, lulet/tek kafshët/tek frutat dhe perimet. Edukatorja pyet dhe ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me këto ngjyra në çerdhe. **Lojë energjike**: Kënga lëvizore 1 ose 2, lojë me shami, me top. Lojërat zhvillohen në oborr. **Përralla:** "Kutia e bojrave". **Punë dore me plastelinë:**Edukatorja ndihmon fëmijët të krijojnë ylberin me plastelinë.	Manuali i Vjershave Mjete didaktike: plastelinë, fletë A4. Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.34)

Tema mujore: Format e argëtimit Tema e javës: Lojërat me numrat.			
Java III	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Përsërisim numrat 1-5  	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me shami, me top, etj. **Përsërisim numrat**: Përsëritja e numrave 1-5. Edukatorja ndihmon fëmijët të përsërisin numrat 1-5 duke përdorur 5 shqisat e njeriut (1 hundë/gojë, 2 sy/veshë, 4 gjymtyrë: 2 këmbë/2 duar dhe 5 gishta). **Ngjyrosje:** Fëmijët ngjyrosin rrethorët me numrat nga 1-5, të përgatitur më parë nga edukatorja. **Vjersha**: "Lepuri". **Vjersha**: "1, 2, 3".	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike
E Martë	Krijimi i krimbit me numra 1-3 	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Vjersha**: "Lepuri". **Punë dore**: Ngjitja e numrave tek krimbi i formuar nga rrathët me numra. Fëmijët, me ndihmën e edukatores, ngjisin numrat 1-3 sipas renditjes në fletën e vizatuar. Pas renditjes, së bashku me edukatoren, fëmijët emërtojnë dhe ngjyrat. **Përralla:** "Tri fluturat".	Mjete Didaktike: fletë me ngjyra, gërshërë, ngjitëse, fletë A4, lapsa me ngjyra.
E Mërkurë	Krijimi i krimbit me numra 3-5	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me shami, me karrige, etj. **Punë dore**: Ngjitja e numrave 4-5 tek krimbi i formuar nga rrathët me numra. **Përralla:** "Notoj dhe fluturoj".	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.72)
E Enjte	Numërojmë përmes	**Vjersha**: "Këtu jam unë".	Manuali i Vjershave

	shqisave	**Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Ngjyrosje**: "Ngjyros arushën". **Aktivitet: Numërojmë shqisat e arushit.**Pas ngjyrosjes edukatorja pyet fëmijët: Sa sy ka arushi?/Sa veshë?/Sa këmbë?/Sa duar? Fëmijët i numërojnë pjesët e trupit të ariut sipas pyetjeve që shtron edukatorja. **Përrallë:** "Brunoja, ariu bojëkafe".	Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.74)
Premte	Mësojmë të radhisim	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Loja e trenit**: Loja zhvillohen në oborr. **Vjersha**: "Lepuri". **Punë dore:** Fëmijët në bashkëpunim me edukatoren radhisin lodra/sende të çerdhes, etj. Edukatorja nxit të gjithë fëmijët të radhisin dhe emërtojnë deri në 5 sendet.	Mjete Didaktike: plastelinë, mbështjellëse/letra për kekë, shkopinj druri, fletë me ngjyra.

Tema mujore: Format e argëtimit

Tema e javës: Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit

Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Krijimi i kapeles	**Vjersha:** "Topi im". **Lojë energjike**: me top. Lojërat zhvillohen në oborr. **Bisedë**: edukatorja bisedon me fëmijët lidhur me festën e 1 Qershorit**.** Çfarë është Festa e 1 Qershorit, çfarë bëjnë fëmijët gjatë festës së 1 Qershorit. Iu tregon se do të bëhet një festë për fëmijët gjatë saj, iu tregon se ata aty do të recitojnë, luajnë dhe këndojnë. **Vjersha**: "1 Qershori". **Kënga** "1 Qershori". **Punë dore**: Kapelet e 1 Qershorit.Edukatoret me fletë kartoni bëjnë kapele sipas ilustrimit në këtë material duke jua treguar fëmijëve.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: fletë kartoni të bardha ose me ngjyra.
E Martë	Ngjyrosja ose zbukurimi i kapeles	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja dhe lojë me shami. Lojërat zhvillohen në oborr. **Vjersha**: "1 Qershori". **Kënga** "1 Qershori". **Punë dore:** Edukatoret ngjyrosin ose ngjisin topa me ngjyra tek kapelet e tyre duke i pyetur fëmijët për ngjyrat e topave apo	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë me ngjyra.

		zbukurimeve dhe cilat ngjyra ata pëlqejnë në kapelet e tyre (të krijuara një ditë më parë).	
E Mërkurë	Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit	**Vjersha:** "Dallëndyshja". **Përralla:** "3 fluturat". Paraqitje me video-projektor. **Vjersha**: "1 Qershori". **Kënga** "1 Qershori".	Manuali i Vjershave Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fletë A4.
E Enjte	Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit	**Vjersha**: "Tullumbace të kam xhan". **Përralla:** "3 fluturat". Edukatorja vendos fëmijët më të vegjël ta shikojnë përrallën e improvizuar nga fëmijët në grupet e mëdha. Aktiviteti zhvillohet në oborr. **Vjersha**: "1 Qershori". **Kënga** "1 Qershori". **Ngjyrosje/Punë dore: krijojmë kartolinat për 1 Qershorin.** Fëmijët ngjyrosin me ndihmën e edukatoreve lulet e pranverës si, luledielli, tulipanët, trëndafilat duke krijuar një kartolinë për shokun/shoqen e grupit.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike
E Premte	Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Vjersha**: "1 Qershori". **Kënga** "1 Qershori". **Lojë e lirë.**	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJSH
MUAJI MAJ

PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Kuriozitete për muajin MAJ

Çfarë duhet të dimë për muajin Maj?

* Muaji Maj është muaji i tretë i stinës së pranverës.
* Muaji Maj është cilësuar si muaji i buzëqeshjeve.
* Muaji Maj është cilësuar si muaji i biçikletave.
* Muaji Maj është cilësuar si muaji i fotografisë.
* Muaji Maj është cilësuar si muaji i luleshtrydhes.
* Në muajin Maj çelin luleboret, trëndafili dhe tulipani.

Muaji Maj- Tema: Sportet dhe lojërat

Grupi: 24-36 muajsh

* **Java I**: Sportet: futbolli, basketbolli, volejbolli dhe tenisi
* **Java II**: Lojërat me ngjyrat
* **Java III**: Lojërat me numrat
* **Java IV**: Programi për 1 Qershorin



Tema mujore: Sportet dhe lojërat

Temat Javore	**Qëllimi**	**Koha e realizimit**
Njohja me sportet kryesore	Njohja me sportet kryesore si: futbolli, volejbolli, tenisi, baskebolli.	Java I
Lojërat me ngjyrat	Përsëritja e ngjyrave kryesore përmes punës së dorës dhe lojërave.	Java II
Lojërat me numrat	Përsëritja e numrave 1-10 dhe organizimi i aktiviteteve dhe lojërave me këta numra.	Java III
Programi për 1 Qershorin		Java IV

Shënim:

* Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
* Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

Tema mujore: Sportet dhe lojërat			
Tema e javës: Sportet: futbolli, basketboll, volejbolli dhe tenisi			
Java I	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Sporti dhe rëndësi e tij. Njohja me lojën e futbollit. 	**Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu flet fëmijëve për sportet dhe rëndësinë e tyre për shëndetin: sportet forcojnë trupin dhe muskujt/na ndihmojnë të punojmë në grup me të tjerët dhe të krijojmë shoqëri/disa njerëz janë sportistë profesionistë./ Disa lojëra zhvillohen në skuadër: futbolli, bashketbolli, volejbolli, etj./Në disa lojëra njerëzit garojnë vetëm: noti, vrapimi, etj. **Bisedë edukatore-fëmijë për rregullat e futbollit dhe mjetet për të lozur atë:** **-**Futbolli luhet me top dhe me dy skuadra me uniforma të ndryshme/Futbolli luhet në fusha/stadiume dhe drejtohet nga arbitri./Futbolli është lojë shumë e dashur dhe lojtarët respektojnë njëri-tjetrin./Skuadra jonë e zemrës është Shqipëria. **Loja e futbollit:** Loja zhvillohet në oborr. Edukatorja mëson dhe ndihmon fëmijët të godasin topin me këmbë. **Vjersha**: "Topi im". **Përralla:** "Ndeshje në fushëgjelbër". **Ngjyrosje:** Fëmijët ngjyrosin një top, të përgatitur më parë nga edukatorja.	Mjete Didaktike: fletë A4 të baardha, lapsa me ngjyra Libri "365 rrëfenja para gjumit".
E Martë	Njohja me lojën e volejbollit.	**Bisedë edukatore-fëmijë për rregullat e volejbollit dhe mjetet për të lozur atë:** Krijimi i dy skuadrave, zbatimi i rregullave të lojës, përdorimi i topit, rrjetave dhe uniforma e veshjes për secilën skuadër./Një arbitër vëzhgon lojën gjatë gjithë kohës./Publiku që e shikon lojën në pallatin e sporteve ose në televizor. **Loja e volejbollit:** Loja zhvillohet në oborr dhe edukatorja ndihmon fëmijët t'ia pasojnë/presin topin me duar njëri-tjetrit.	Mjete Didaktike Manuali i Vjershave

		Vjersha: "Topi im". **Punë dore:** Krijimi i topave me plastelinë. Fëmijët zgjedhin ngjyrën/ngjyrat që preferojnë për topin e tyre.	
E Mërkurë	Loja e tenisit.	**Vjersha** "Balona". **Loja e tenisit:** "Të luajmë tenis me tullumbace". (Vendosini fëmijët dy e nga dy përballë njëri tjetrit, jepini atyre nga një raketë tenisi (nëse nuk disponohen raketa, përdoren pjatat plastike/karton në vend të raketës). Jepini fëmijës nga një tullumbac, lërini të lirë të zgjedhin ngjyrën që ata dëshirojnë. Ndihmojini fëmijët të gjuajnë tullumbacin me raketë). Loja zhvillohet në oborr. **Përralla:** "Stërvitja". **Lojë e lirë:** me kuba, kukulla, lodra, etj.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.137)
E Enjte	Loja e basketbollit 	**Bisedë edukatore-fëmijë për rregullat e basketbollit dhe mjetet për të lozur atë:** Krijimi i dy grupeve me fëmijë , zbatimi i rregullave të lojës duke hedhur topin në koshin me rrjet. **Loja e basketbollit:** Loja zhvillohet në ambjentin e grupit dhe edukatorja ndihmon fëmijët të respektojnë rradhën me njëri-tjetrit. Çdo top i hedhur saktë në kosh është një pikë plus për secilën skuadër. **Vjersha**: "Topi im". **Lojë e lirë:** me kuba, kukulla, lodra, etj.	Manuali i Vjershave
E Premte	Mësojmë të vizatojmë një buzëqeshje. 	**Vjersha**: "Topi im". **Lojë energjike**: me shami, me top, me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Bisedë: edukatore-fëmijë:** Edukatorja iu shpjegon fëmijëve që muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve. Ajo fton fëmijët të imitojnë me mimikë një buzëqeshje. **Aktivitet:** Fëmijët mësojmë të vizatojnë fytyrën e buzëqeshur. Pas vizatimit ata e ngjyrosin fytyrën me ngjyrën sipas dëshirës. **Përralla**: "Kampioni i notit".	Mjete didaktike: letra dhe lapsa me ngjyra. Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.79)

Tema mujore: Sportet dhe lojërat
Tema e javës: Njohja me ngjyrat

Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Ngjyra e kuqe 	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Lojë energjike**: me shami, me top, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Vjersha**: "Qershia". **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e kuqe dhe se ku e gjejmë atë: në natyrë, tek bimët, lulet, pemët, kodrat/tek kafshët, si p.sh: nusepashka, gaforrja/tek frutat dhe perimet: mollët, qershitë, luleshtrydhet, domatet, etj. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të kuqe që ndodhen në çerdhe. **Punë dore:** Krijimi i gaforres së detit. Edukatoret mund të përdorin ilustrimin e këtij materiali.	Mjete Didaktike: karton A3/mbështjellëse keku, letra me ngjyrë të kuqe/rozë, lapsa me ngjyra.
E Martë	Ngjyra e gjelbër	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e gjelbër dhe se ku e gjejmë atë: në natyrë, tek bimët, lëndinat/tek kafshët: bretkosa, etj/tek frutat dhe perimet: speci, kungulleshkat, kastraveci, spinaqi, selinoja, brokoli. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet	Mjete Didaktike: plastelinë Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.74)

		me ngjyrë të gjelbër që ndodhen në çerdhe. **Bisedë**: Bretkosa. Edukatorja iu flet fëmijëve për bretkosën, ku qëndron ajo (në lum, liqen), tingullin që lëshon, etj. **Përralla:** "Bretkosa e gjelbër". **Ngjyrosje ose punë dore**: fëmijët ngjyrosin/bëjnë me plastelinë një bretkosë. (Edukatoret të përdorin ilustrimet në këtë material).	
E Mërkurë	Ngjyra blu 	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën blu/e kaltër dhe se ku e gjejmë atë: ngjyra e detit, qiellit. **Aktivitet me tullumbace**: Fëmijët me ndihmën e edukatores fryjnë tullumbace blu, të kaltra dhe lozin me to. Aktiviteti zhvillohet në oborr. **Vjersha:** "Dola vizaton". **Punë dore me plastelinë:** "Krijimi i peshkut blu".	Manuali i Vjershave Mjete didaktike: plastelinë, kopsa.
E Enjte	Ngjyra e verdhë Krijojmë me punë dore luledielin/bletën	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e verdhë dhe se ku e gjejmë atë: në natyrë, tek bimët si: luledielli)/tek kafshët, insektet, si bleta, etj/tek frutat dhe perimet, si p.sh, pjepri, speci, kungulli, banania, limoni. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të verdhë që ndodhen në çerdhe. **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr. **Ngjyrosje:** Fëmijët krijojnë me punë dore/ngjyrosin luledielin/bletën. Edukatoret mund të përdorin ilustrimet në këtë material për ngjyrosje. **Vjersha**: "Semafori"	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë të bardha A4.
E	Ngjyra portokalli	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit".	Manuali i Vjershave

Premte	Krijojmë ylberin me plastelinë	**Bisedë edukatore-fëmijë**: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën portokalli dhe se ku e gjejmë atë: në natyrë, tek bimët, lulet/tek kafshët: dhelpra/tek frutat dhe perimet: portokalli, karrotat. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë portokalli në çerdhe. **Lojë energjike**: me shami, me top. Lojërat zhvillohen në oborr. **Përralla:** "Tri fluturat". **Punë dore me plastelinë/ngjyrosje:** Krijimi i ylberit.	Mjete didaktike: plastelinë/lapsa, fletë A4.
Tema mujore: Sportet dhe lojërat **Tema e javës: Lojërat me numrat.**			
Java III	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Përsërisim numrat 1-5 	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me shami, me top, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Përsërisim numrat**: Përsëritja e numrave 1-5. Edukatorja ndihmon fëmijët të përsërisin numrat 1-5 duke përdorur 5 shqisat e njeriut (1 hundë/gojë, 2 sy/veshë, 4 gjymtyrë: 2 këmbë/2 duar dhe 5 gishta). **Ngjyrosje:** Fëmijët ngjyrosin rrethorët me numrat nga 1-5, të përgatitur më parë nga edukatorja. **Vjersha**: "Numrat".	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike
E Martë	Krijimi i krimbit me numra 1-5 	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Vjersha**: "Numrat". **Punë dore**: Ngjitja e numrave tek krimbi i formuar nga rrathët me numra. Fëmijët, me ndihmën e edukatores, ngjisin numrat sipas renditjes në fletën e vizatuar. Pas renditjes, së bashku me edukatoren, fëmijët emërtojnë dhe ngjyrat.	Mjete Didaktike: fletë me ngjyra, gërshërë, ngjitëse, fletë A4, lapsa me ngjyra.

		Përralla: "Tri fluturat".	
E Mërkurë	Krijimi i krimbit me numra 6-10	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me shami, me top, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Vjersha:** "Dallëndyshja". **Punë dore**: Ngjitja e numrave 6-10 tek krimbi i formuar nga rrathët me numra. **Përralla:** "Notoj dhe fluturoj".	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.72)
E Enjte	Numërojmë përmes shqisave	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. **Vjersha**: "Numrat". **Aktivitet: Numërojmë shqisat e arushit.** Pas ngjyrosjes edukatorja pyet fëmijët: Sa sy ka arushi?/Sa veshë?/Sa këmbë?/Sa duar? Fëmijët i numërojnë pjesët e trupit të ariut sipas pyetjeve që shtron edukatorja. **Përrallë:** "Brunoja, ariu bojëkafe". **Ngjyrosje**: "Ngjyros arushën".	Manuali i Vjershave Libri "365 rrëfenja para gjumit". (f.74)
Premte	Mësojmë të radhisim 	**Vjersha:** "Më gëzon në Maj ti mua". **Loja e trenit**: Loja zhvillohen në oborr. **Vjersha**: "Numrat". **Punë dore:** Fëmijët në bashkëpunim me edukatoren krijojnë një radhë lulesh duke iu vënë nga një numër secilës në mes. (Edukatoret të ndihmojnë fëmijët duke përdorur ilustrimet e punës në këtë material).	Mjete Didaktike: plastelinë, mbështjellëse/letra për kekë, shkopinj druri, fletë me ngjyra.

Tema mujore: Sportet dhe lojërat			
Tema e javës: Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit			
Java IV	**Rubrika**	**Aktivitetet**	**Mjetet e Punës**
E Hënë	Krijimi i kapeles	**Vjersha:** "Topi im". **Lojë energjike**: me top. Lojërat zhvillohen në oborr. **Bisedë**: edukatorja bisedon me fëmijët lidhur me festën e 1 Qershorit**.** Çfarë është Festa e 1 Qershorit, çfarë bëjnë fëmijët gjatë festës së 1 Qershorit. Iu tregon se do të bëhet një festë për fëmijët gjatë saj, iu tregon se ata aty do të recitojnë, luajnë dhe këndojnë. **Vjersha**: "1 Qershori".	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: fletë kartoni të bardha ose me ngjyra.

		Kënga “1 Qershori”. **Punë dore**: Kapelet e 1 Qershorit. Me ndihmën e edukatores dhe me fletë kartoni fëmijët bëjnë kapele sipas ilustrimit në këtë material.	
E Martë	Ngjyrosja ose zbukurimi i kapeles 	**Vjersha:** “Më gëzon në Maj ti mua”. **Lojë energjike**: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja dhe lojë me shami. Lojërat zhvillohen në oborr. **Vjersha**: “1 Qershori”. **Kënga** “1 Qershori”. **Punë dore:** Fëmijët ngjyrosin ose ngjisin topa me ngjyra tek kapelet e tyre (të krijuara një ditë më parë).	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë me ngjyra.
E Mërkurë	Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit	**Vjersha:** “Dallëndyshja”. **Përralla:** “3 fluturat”. Edukatorja ndihmon fëmijët të improvizojnë përrallën. Aktiviteti zhvillohet në oborr. **Vjersha**: “1 Qershori”. **Kënga** “1 Qershori”.	Manuali i Vjershave Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fletë A4.

E Enjte	Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit	**Vjersha**: "Ora e qytetit". **Përralla:** "3 fluturat". Edukatorja ndihmon fëmijët të improvizojnë përrallën. Aktiviteti zhvillohet në oborr. **Vjersha**: "1 Qershori". **Kënga** "1 Qershori". **Ngjyrosje/Punë dore: krijojmë kartolinat për 1 Qershorin.** Fëmijët ngjyrosin/bëjnë me punë dore lulet e pranverës si, luledielli, tulipanët, trëndafilat duke krijuar një kartolinë për shokun/shoqen e grupit.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike
E Premte	Pregatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit Krijojmë pemën e grupit të fëmijëve.	**Vjersha:** "Ngjyrat e ylberit". **Përralla:** "3 fluturat". Edukatorja ndihmon fëmijët të improvizojnë përrallën. Aktiviteti zhvillohet në oborr. **Vjersha**: "1 Qershori". **Punë dore: Krijojmë pemën e grupit të fëmijëve.** Prindërit e fëmijëve sjellin me foto një objekt të preferuar të fëmijëve që e vënë krahas fotos së fëmijëve. Fëmijët prezantojnë veten përpara shokëve.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike